



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-018
Prishtinë, më 15 prill 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 15 PRILL 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Emrush Haxhiu, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi dhe Shefki Shoshaj.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

- 1. Kërkesat për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit,*
- 2. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2016-2018,*
- 3. Propozimi për miratimin e Katalogut të vendeve të punës për shërbyesit civilë të Administratës së Kuvendit.*

1. Kërkesat për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit

1.1 Kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme për lejimin e vizitës zyrtare në Çeki, prej 27-29 prill 2015

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit, në këtë përbërje: Blerta Deliu-Kodra, Ismet Beqiri, Qerim Bajrami dhe Zafir Berisha, si dhe nga stafi mbështetës i komisionit, Minire Hasani, në Çeki, prej 27-29 prill 2015.
2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi, si dhe shpenzimet e përkthimit (anglisht-shqip dhe anasjelltas) për delegacionin mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

1.2 Kërkesa për lejimin e vizitës zyrtare në Shqipëri, prej 20-21 prill 2015

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme, në këtë përbërje: Enver Hoxhaj, Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Puhije Demaku, Zafir Berisha dhe Ramush Haradinaj, si dhe nga stafi mbështetës i komisionit, Manush Krasniqi, në Shqipëri, prej 20-21 prill 2015.
2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi, si dhe shpenzimet për një vizitë të Kuvendit, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

1.3 Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të delegacioneve nga komisionet parlamentare të Republikës së Shqipërisë, që do ta vizitojnë Kuvendin e Republikës së Kosovës

V E N D I M

1. Të ftohen katër (4) komisione parlamentare nga Kuvendit i Republikës së Shqipërisë për vizitë zyrtare në Kuvendin e Republikës së Kosovës, si në vijim:

- Komisioni për Ekonomi dhe Financa,
- Komisioni për Çështje Ligjore, Administratë Publike dhe të Drejtat e Njeriut,
- Komisioni për Integritet Evropian dhe
- Komisioni për Punë të Jashtme.

2. Të gjitha shpenzimet e dala me rastin e pritjes së delegacioneve të komisioneve parlamentare nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, të lartshënuara në pikën një (1) të këtij vendimi, që do ta vizitojnë Kuvendin e Republikës së Kosovës, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

1.4 Kërkesa për lejimin e udhëtimit në Gjermani, prej 14-18 prill 2015

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetes së Kuvendit, Njomza Emini, në Gjermani, prej 14-18 prill 2015.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimit për të lartshënuarën në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

1.5 Kërkesa për lejimin e vizitës zyrtare në Kroaci, prej 24-26 prill 2015

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputeteve të Kuvendit: Vjosa Osmani dhe Donika Kadaj-Bujupi, në Kroaci, prej 24-26 prill 2015.

2. Shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimit mbulohen nga organizatori, ndërsa mëditjet shtesë për të lartshënuarat në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

1.6 Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtarë në Serbi, prej 24-26 prill 2015

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit: Besim Beqaj dhe Sadri Ferati, në Serbi, prej 24-26 prill 2015.

2. Shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimit mbulohen nga organizatori, ndërsa mëditjet shtesë për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në këtë përbërje: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Aida Dërguti, nënkryetarë të Kuvendit; Enver Hoxhaj, Teuta Sahatqija, Ganimete Musliu, Pal Lekaj, Haxhi Shala, deputetë të Kuvendit; Burhan Selimi, Gëzim Kasapolli, këshilltarë të kryetarit të Kuvendit; Shaban Selimi dhe Tringa Lila, zyrtarë nga Protokolli i Administratës së Kuvendit, si dhe Bashkim Rrahmani dhe Shaip Shabani, zyrtarë për siguri të kryetarit të Kuvendit; Fatos Shala, zyrtar për Media dhe Shpresim Shala, zyrtar për media-fotograf, për të marrë pjesë në takimin VII ndërparlamentar “Parlamenti Evropian – Kosova”, që do të mbahet në Strasburg (Francë), prej 28 prill deri më 1 maj 2015.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi, si dhe tejkalimin në bazë të rezervimit për të lartshënuarit në pikën (1) një të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, 2016-2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi Kornizën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitet 2016-2018.

2. I rekomandohet Ministrisë së Financave që e njëjta të përfshihet në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2016-2018.

3. Propozimi për miratimin e Katalogut të vendeve të punës për shërbyesit civilë të Administratës së Kuvendit

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Administratës së Kuvendit në bazë të nenit 80.2 të Rregullores së Kuvendit, specifikave të punës së shërbyesve civilë të Administratës së Kuvendit, specifikave të punës që janë paraparë edhe në nenin 3 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me kërkesën e Raportit të Progresit 2013 të Komisionit Evropian për Kosovën, e ka përgatitur Katalogun e vendeve të punës për shërbyesit civilë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ia ka propozuar Kryesisë së Kuvendit miratimin e tij.

Kryesia, pasi u njoftua më hollësisht nga sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi lidhur me Propozim-Katalogun e vendeve të punës për shërbyesit civilë të Administratës së Kuvendit, miratoi këtë:

V E N D I M

Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas propozimit të sekretarit të përgjithshëm të Kuvendit.

2. Ngarkohet Ministria e Administratës Publike që t'i ekzekutojë pagat e shërbyesve civilë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas këtij vendimi - Katalogut të vendeve të punës për shërbyesit civilë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe sipas hapit të gradave.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 11:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale